

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

ПОЛИЦИСКИ ИНСПЕКТОРАТ КИСОВА / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajvali - Prishtinë

Nr. / Br. 04-052-2349/3

Data / Datum 25.10.2017



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**

---

**RAPORT  
I INSPEKTIMIT MBI MENAXHIMIN E PATRULLIMEVE NË TRAFIK  
DHE SIGURISË NË RRUGË**

Nr. 2/2017

Prishtinë, 25 tetor 2017

## Informata të përgjithshme

**Titulli** Raport i inspektimit mbi menaxhimin e patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë

**Data e përgatitjes** 25 tetor 2017

**Përgatitur nga** Fitore Gajraku, inspektor,  
Kadri Keçmezi, inspektor,  
Mirsad Puçurica, inspektor,  
Xhavit Fetahaj, inspektor

**Mbikëqyrur nga** Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit  
Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit

**Mbështetur nga** Bujar Mustafa  
Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi

**Dorëzuar nga** Bekim Pira  
Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit

**Miratuar nga** Hilmi Mehmeti  
Kryeshef Ekzekutiv  
Inspektorati Policor i Kosovës

**Data e miratimit** 25 tetor 2017



### 1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)
- 1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....(5-5)

### 2. Hyrje

- 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)
- 2.2. Qëllimi.....(6-6)
- 2.3. Objekti.....(6-6)
- 2.4. Subjekti.....(6-6)
- 2.5. Objektivat e inspektimit.....(7-7)
- 2.6. Rëndësia e inspektimit.....(7-7)
- 2.7. Metodologjia e inspektimit.....(7-8)
- 2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit.....(8-8)
- 2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit.....(8-8)
- 2.10. Drejtimet e inspektimit.....(8-8)
- 2.11. Kriteret e vlerësimit.....(8-9)
- 2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(9-9)

### 3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1. Organizimi dhe rregullat e funksionimit të policisë për patrullim....(10-13)
- 3.2. Strategjia dhe planet për sigurinë rrugore.....(14-15)
- 3.3. Performanca policore në ngritjen e sigurisë në trafik.....(15-19)
- 3.4. Pajisjet policore të njësive patrulluese.....(19-20)

### 4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1. Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(21-22)

Shtojcat



## 1. Përmbledhja ekzekutive

---

### 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Në drejtim të ngritjes së sigurisë së përgjithshme në trafikun rrugor, Policia e Kosovës (PK) realizon patrullime të rregullta në trafik dhe realizimi i tyre arrihet përmes njësive patrulluese, të cilat fushëveprimin e tyre e kanë të ndarë sipas zonave të përgjegjësive apo gjatësisë së rrugëve që kanë nën kompetencë të mbikëqyrjes. Lidhur me shtrirjen e fushëveprimit të këtyre njësive, është vlerësuar se nuk ka paqartësi sa i përket kompetencave të kontrollit apo mbikëqyrjes së zonave të përgjegjësive, qoftë në nivel stacionesh policore të rendit publik, apo në nivel të njësive të trafikut rrugor. Puna e këtyre njësive për siguri në trafik është rregulluar me një numër aktesh ligjore dhe nënligjore, fondin e të cilave e ka pasuruar edhe një Rregullore e nxjerrur së fundmi (Rregullore për Operativë)<sup>1</sup>. Rregullorja përcakton fushëveprimin e patrullimit policor, zonat e përgjegjësive, patrullimin me biçikleta, përdorimin e motoçikletave, ndaljen e automjeteve, ndalimin e mjeteve me rrezikshmëri të lartë, ndaljen e automjeteve me mbingarkesë dhe jashtë dimensioneve, trafikun rrugor dhe fusha tjera. Sa i përket kapaciteteve të burimeve njerëzore në mbulimin e zonave të përgjegjësive, në stacione policore vërehen vështirësi në krijimin e ekipeve patrulluese me përbërje të plotë për 24 orë. Lidhur me mbajtjen e evidencave mbi ngjarjet dhe aktivitetet 24 orëshe, vërehen mangësi në radiologji që më tepër kanë të bëjnë me mosprezantim të informatave të detajuara mbi aktivitetet (koha e reagimit, koha e daljes në vendngjarje dhe e përfundimit të aktivitetit policor). Nevojitet mobilizim i vazhdueshëm i menaxherëve të njësive dhe stacioneve policore në ushtrimin e kontroleve më të shpeshta menaxheriale, në drejtim të ngritjes së përkushtimit, llogaridhënies dhe motivit për punë. Menaxhimi i aksidenteve kërkon trajtim adekuat të situatave të përcjella me pasoja, andaj përhurma në programe trajnuese të avansuara e ekipeve patrulluese të stacioneve, do t'i kontribuojë ngritjes së cilësisë së shërbimit.

1.1.2. PK-ja konsiderohet një nga akterët kyç në Strategjinë kombëtare për sigurinë rrugore, andaj janë marrë përgjegjësi dhe detyra që brenda periudhës pesë (5) vjeçare (2016-2020), së bashku me akterët tjerë implementues të Planit Veprues, të reduktohet numri i aksidenteve, të vdekurve dhe i të lënduarve. PK-ja ka nxjerrë Planin Zhvillimor Strategjik dhe plane tjera vjetore, që orientojnë aktivitetet në ngritjen e gjendjes në komunikacion, duke vendosur prioritete bazuar në Strategjinë kombëtare për siguri rrugore. Vërehet se masat e parapara policore për përmirësimin e gjendjes në komunikacion, trajtohen nga disa akterë brenda Policisë, përfshirë Divizionin e Sigurisë Publike (DSP) dhe Divizionin për Komunikacionin Rrugor (DKRR). Senzibilizimi i opinionit publik mbi rëndësinë e sigurisë rrugore, bashkëpunimi me akterët tjerë të përfshirë në realizimin e objektivave strategjike, përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Infrastrukturës (MI), Drejtorinë e Menaxhimit të Rrugëve, Inspektoratin e Ministrisë së Infrastrukturës, komunat, forumet e sigurisë, shoqërinë civile dhe mediet, vlerësohet të jetë i kënaqshëm. Pikë me rëndësi në krijimin e kushteve për punë cilësore dhe efikase të PK-së mbetet edhe përmbushja e kriterit mbi pajimin me pajisje teknike që krijojnë cilësi të shërbimit në ngritjen e sigurisë në trafik, të njohura si pajisje teknike të zbatimit të masave ligjore (pajisje për rregullim, kontrollim, identifikim dhe dëshmim të kundërvajtjeve). Nevojitet përkushtim policor për qasje më aktive në problematikën e trajtimit të pikave të zeza, drejt përmblylljes së procesit të identifikimit të tyre, si faktor i rrezikimit të sigurisë rrugore.

---

<sup>1</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, *Rregullore për Operativë në Policinë e Kosovës*, 11 prill 2017, Prishtinë.

1.1.3. Synimi i Strategjisë kombëtare për siguri rrugore është që me përfshirjen e shumë akterëve, të përmirësohen kushtet në trafikun rrugor drejt reduktimit apo zvogëlimit të numrit të aksidenteve dhe fataliteteve, duke u përfruar me kushtet brenda vendeve të Bashkimit Evropian. Edhe pse është herët të jepet vlerësim mbi arritjen e synimeve të tilla, vlerësohet se arritja e parametrave të sigurisë rrugore është larg për t'u arritur. Mbetet që arritja e parametrave të tillë të vlerësohet në vitin 2019, kur do të krahasohen trendet me vitin 2007. Ajo që bie në sy është që përgjithësisht, shtimi i masave pro-aktive policore të sigurisë në rrugë nga PK-ja nuk del të jetë faktor vendimtar në ngritjen e sigurisë rrugore, duke nënkuptuar se PK-ja do të mbetet vetëm një nga akterët që mund të kontribuojë në këtë drejtim. Nevojitet një qasje më aktive dhe më gjithëpërfshirëse e shumë akterëve, përfshirë edhe kontributin e vetë pjesëmarrësve në trafik rrugor. Raportet policore dëshmojnë se përgjithësisht janë shtuar masat pro-aktive nga PK-ja për krijim të kushteve të sigurisë në rrugë, por që dalin të jenë të pamjaftueshme të ulin trendin e aksidenteve. Shtimi i masave pro-aktive nënkupton shtimin e numrit të patrullimeve brenda zonave të përgjegjësisë të njëjësive patrulluese policore, shtimin e numrit të gjobave për ngasësit që shkelin rregullat e trafikut dhe shtimin e pikave të kontrollit. IPK-ja çmon angazhimet policore në ngritjen e masave të sigurisë në rrugë, duke kërkuar angazhim të shtuar të disa njëjësive të trafikut, që performanca e tyre mund të rezultojë më e avancuar.

1.1.4. Vlerësohet se për të ngritur masat pro-aktive policore të sigurisë rrugore, njësitë patrulluese duhet të jenë mirë të pajisura me mjete pune, të cilat ngrisin edhe performancën e tyre. Inspektimi i kryer në nivel stacionesh policore dhe atë të njëjësive rajonale të komunikacionit rrugor vë në pah një gjendje jo të mirë të pajisjes së ekipeve patrulluese me mjete pune, siç janë pajisjet për matjen e shpejtësisë së lëvizjes (radar) dhe pajisje për matjen e prezencës së alkoolit tek personat e dehur (alkooteste). Këtë gjendje e vështirëson edhe mos funksionimi i një numri pajisjesh për shkak të gjendjes jo të rregullt teknike. Në këtë drejtim, nevojitet një rishikim i përgjithshëm i nivelit të pajimit të të gjitha njëjësive patrulluese me pajisje të punës, duke përfshirë edhe pajisjet tjera të nevojshme për punën në terren të ekipeve patrulluese mbi menaxhimin e aksidenteve në rrugë.

## **1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve**

1.2.1. Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga gjashtë (6) rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar (menaxhimi i patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë, nr. 04/2015), dy (2) prej tyre janë realizuar plotësisht, dy (2) janë në proces të realizimit dhe dy (2) janë realizuar pjesërisht (*për më tepër referoju tabelës në shtojcën 1*).

## 2. Hyrje

---

### 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Policinë e Kosovës (PK), për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë, për të siguruar një shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit (2017) ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha menaxhimi, përfshirë edhe menaxhimin e patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet fushë me interes për IPK-në, për të vlerësuar nivelin e përkushtimit të strukturës policore në kohën kur shumë akterë shtetëror janë përfshirë në përmbushjen e objektivave strategjike për ngritjen e sigurisë në komunikacion rrugor, me qëllim të reduktimit të numrit të aksidenteve dhe pasojave të tyre. Prandaj, është nevoja që një roli policor brenda këtyre angazhimeve të jetë prioritar, i mbështetur në burime të mjaftueshme dhe disponueshme njerëzore dhe teknike. Duke kuptuar rëndësinë e kësaj fushe, mbi bazën e Programit të miratuar të punës inspektuese të datës 16 shkurt 2017, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka inicuar inspektim (të ndarë në dy pjesë, në rendin publik dhe trafikun rrugor) për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit.

### 2.2. Qëllimi i inspektimit

2.2.1. Qëllimi i inspektimit është:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat policore përkatëse zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet,
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj,
- Që të jepet një opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me këtë fushë të menaxhimit,
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së PK-së në fushën përkatëse,
- Të identifikojë mangësitë apo dobësitë dhe të rekomandojë masa ligjore dhe organizative për funksionimin më të mirë të PK-së.

### 2.3. Objekti i inspektimit

2.3.1. Në këtë inspektim është vlerësuar kryerja e detyrave policore në fushën e menaxhimit të patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë.

### 2.4. Subjekti i inspektimit

2.4.1. Inspektimi është përqendruar në Divizionin e Komunikacionit Rrugor dhe Divizionin për Siguri Publike, që të dy këto në kuadër të Departamentit të Operacioneve të Policisë së Kosovës.

## 2.5. Objektivat e inspektimit

### 2.5.1. Objektivat që ka synuar t'i arrijë ky inspektim janë:

- Të vlerësohet organizimi dhe funksionimi i njësive policore për aktivitetet patrulluese në kuadër të zonës së përgjegjësisë,
- Të vlerësohet efikasiteti policor në marrjen e masave pro-aktive dhe reaktive në drejtim të ngritjes së sigurisë në zonën e përgjegjësisë,
- Të vlerësohen pajisjet dhe kushtet e nevojshme të punës së njësive patrulluese,
- Të identifikohet dhe vlerësohet mbikëqyrja e zyrtarëve policorë nga menaxhmenti drejtues.

## 2.6. Rëndësia e inspektimit

### 2.6.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Marrjen e masave pro-aktive dhe reaktive për ngritjen e nivelit të sigurisë së përgjithshme të trafikut rrugor, reduktimin e numrit të aksidenteve të komunikacionit, me këtë edhe rënien e numrin të fataliteteve dhe lëndimeve në aksidente,
- Ngritjen e shkallës së përgjegjësisë dhe performancës së ekipeve dhe njësive patrulluese në menaxhimin e patrullimeve në zonat e tyre të përgjegjësisë,
- Identifikimin e vështirësive që sfidojnë arritjen e objektivave strategjike dhe planeve operative për sigurinë rrugore,
- Ngritjen e bashkëpunimit policor dhe kultivimin e raporteve të mira me partnerët tjerë të përfshirë në nismat për sigurinë në rrugë,
- Ngritjen e nivelit të profesionalizmit, përgjegjësisë dhe përkushtimit policor drejt krijimit të një ambienti të sigurt rrugor dhe ngritjen e besimit të qytetarëve tek PK-ja.

## 2.7. Metodologjia e inspektimit

### 2.7.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar intervista dhe takime me 81 punonjës policorë, si në vijim:
  - Udhëheqësin e Divizionit për Siguri Publike,
  - Udhëheqësin e Divizionit të Komunikacionit Rrugor,
  - Shefat e Sektorëve Rajonal për Operativë.
  - Komandantët e Stacioneve Policore,
  - Shefat e Njësive Rajonale të Komunikacionit Rrugor,
  - Udhëheqësi i Njësive për Kontrollin e Autostradës,
  - Udhëheqësit e Zyrave operative në kuadër të Njësive Rajonale të Komunikacionit Rrugor dhe Njësive për Kontrollin e Autostradës,
  - Udhëheqësit e ekipeve patrulluese të Njësive Rajonale të Komunikacionit Rrugor dhe Njësive për Kontrollin e Autostradës,
  - Zyrtarë policorë të ekipeve patrulluese.
- b) Janë kryer vëzhgime, këqyrje apo kontrollime të dosjeve, si në vijim:
  - Janë kontrolluar pajisjet e ekipeve patrulluese në terren,
  - Dokumentet e nevojshme për punën në terren të ekipeve patrulluese.

- Janë plotësuar formularët e inspektimit lidhur me pajimin e ekipeve patrulluese me pajisjet e nevojshme për punë.
- c) Janë siguruar dëshmitë, si në vijim.
  - Strategjia e sigurisë rrugore dhe Plani i Veprimit në Kosovë,
  - Plani Strategjik Zhvillimor i PK-së,
  - Plani Vjetor i Departamentit të Operacioneve (2016),
  - Analiza mbi gjendjen e sigurisë rrugore (2016),
  - Lista e Autorizuar e Personelit, përfshirë strukturën dhe shpërndarjen e personelit,
  - Lista e planeve operative të angazhuar,
  - Kopje të mostrave të planeve operative dhe raporteve pos-operacionale,
  - Plani Vjetor i Punës së PK-së (2016),
  - Raporti Vjetor i Punës së PK-së(2016),
  - Raportet vjetore të DRP-ve (2016),
  - Raporti Vjetor i DKRR-së (2016),
  - Raportet e ndërrimeve, oraret, radiologjet, fletëpatrullat dhe raportet tjera.

## **2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit**

2.8.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 20.02.2017 dhe ka përfunduar më datë 24.04.2017.

## **2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit**

2.9.1. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave policore gjatë periudhës kalendarike janar-dhjetor 2016. Veç tjerash, inspektimi është fokusuar edhe në gjendjen aktuale, siç është rasti i kontrollimit të pajisjeve të ekipeve patrulluese.

## **2.10. Drejtimit e inspektimit**

2.10.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Organizimi dhe rregullat e funksionimit të policisë për patrullim,
- Strategjia për sigurinë rrugore,
- Performanca policore në ngritjen e sigurisë së përgjithshme në trafik,
- Pajisjet policore të njëjive dhe kushtet e nevojshme për patrullim.

## **2.11. Kriteret e vlerësimit**

2.11.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave në divizionet, drejtoritë, stacionet apo njësitë policore:

- Ligji për Policinë,
- Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor,
- Strategjia e Sigurisë Rrugore dhe Plani i Veprimit në Kosovë,
- Udhëzuesi për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor,



- Rregullorja nr. 26/2015 për Patrullim,
- Procedura Standarde e Operimit për Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor,
- PSO mbi veprimtarinë e sektorëve policor bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit 2012-2016 dhe Metodologjinë e PK-së për Policimin në Bashkesi,
- Plani Zhvillimor Strategjik i PK-së (2016-2020).

## **2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave**

2.12.1. IPK-ja vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, janë paraqitur vështirësi të natyrës objektive, si pasojë e të cilave, janë inspektuar vetëm 29 ekipe patrulluese në terren, nga 41 sa janë planifikuar. Realizimi i të gjitha vizitave ekipeve patrulluese, është pamundësuar nga angazhimet e tyre në aktivitete operacionale ditore.

### 3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

---

#### 3.1. Organizimi dhe rregullat e funksionimit të policisë për patrullim

3.1.1. Rregullorja për Operativë, patrullimin e definojnë si ‘veprim policor, përmes të cilit mbahet rendi dhe qetësia publike, bëhet sigurimi i pronës, lëvizjes së lirë, kontrollimi i kufirit, rregullimi i trafikut, parandalimi dhe zbulimi i veprave penale, kapja e kryesve të veprave penale, si dhe veprime e aktivitete tjera nga fusha e sigurisë, të cilat bëhen nga Policia në zbatim të ligjit’. Lidhur me fushën që është fokus i inspektimit, Policia kryen patrullime të rregullta policore si aktivitete ditore drejt krijimit të kushteve për sigurinë e përgjithshme të pjesëmarrësve në komunikacion. Siguria në trafik sigurohet me angazhime të njërive policore të rendit dhe të komunikacionit rrugor. Udhëheqja dhe kontrolli i aktiviteteve në fushën e patrullimeve të trafikut dhe sigurisë në rrugë, në nivelin e lartë menaxherial është në kompetencë të Departamentit për Operacione, që ka në varësi Divizionin për Siguri Publike (DSP) dhe Divizionin për Komunikacionin Rrugor (DKRR). DSP-ja është funksionale me tetë (8) drejtori rajonale policore (DRP), që kanë brenda strukturave të tyre 41 stacione policore të kategorizuara në kategori A, B dhe C, të cilat veç tjerash merren edhe me ngritjen e sigurisë në rrugë brenda zonave të përgjegjësisë së tyre. Stacionet policore i trajtojnë rastet e aksidenteve të trafikut me dëme të vogla materiale dhe lëndime të lehta trupore. Në kuadër të DRP-ve janë organizuar edhe njësitë regjionale të komunikacionit rrugor (NJRKRR), që aktivitetet e tyre policore patrulluese i zhvillojnë në rrugët rajonale dhe magjistrale të vendit. Politikat zhvillimore të këtyre njërive realizohen nga DKRR-ja. Në kuadër të DKRR-së funksionon edhe Njësia për Kontrollin e Autostradave (NJKA), që zhvillon aktivitetet e saj në autostradat brenda territorit të vendit. NJRKRR-të dhe NJKA merren me aksidentet e trafikut që rezultojnë me lëndime apo pasoja të rënda dhe fatalitet, të ndodhura në territorin e Kosovës.

3.1.2. Operimi policor në fushën e patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë funksionon brenda kornizës ligjore që rregullon fushën përkatëse, të harmonizuar me Ligjin për Policinë dhe Ligjin për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor. Si akte nënligjore në fuqi lidhur me këtë fushë janë Udhëzimi Administrativ nr. 01/2012 për mënyrën e kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore Rregullorja nr. 26/2015 për Patrullim, Procedura Standarde e Operimit për Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor dhe Procedura Standarde e Operimit mbi veprimtarinë e sektorëve policorë bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit (2012-2016) dhe Metodologjinë e PK-së për Policimin në Bashkësi. Rregullorja për Patrullim ka përcaktuar detyrat e policëve patrullues, ku veç tjerash ka përcaktuar edhe përgjegjësitë në fushën e patrullimit, kontrollin dhe sigurinë në komunikacion. Në kohën kur është zhvilluar inspektimi, IPK-ja ka vërejtur se ka hyrë në fuqi Rregullorja për Operativë, e cila ka trajtuar edhe fushën e patrullimeve, përfshirë trafikun rrugor, patrullimet me biçikleta, patrullimet me motoçikleta, etj.

3.1.3. Për mbulimin e zonave të përgjegjësisë me aktivitet patrullues policor është e nevojshme që njësitë e trafikut dhe të stacioneve policore të jenë të mbuluara me personel të mjaftueshëm policor. Shpërndarja e personelit për këto njësi është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (DPP), që ka hartuar Listën e Autorizuar të Personelit (LAP), me çka ka përcaktuar numrin e punonjësve për secilin stacion apo njësi. Ka mungesë të personelit policor, që nënkupton se në shumicën e stacioneve dhe njërive të trafikut nuk është plotësuar struktura organizative me numrin e përcaktuar të personelit. Në vitin 2016, dy (2) nga tetë (8) NJRKRR (Mitrovicë Jugu, Pejë), kanë

plotësuar numrin e personelit të uniformuar në pajtim me LAP-in. Në kuadër të stacioneve, katër (4) nga 11 stacione të kategorisë A, tre (3) nga 20 stacione të kategorisë B dhe një (1) nga dhjetë (10) stacione të kategorisë C, kanë plotësuar numrin e personelit të uniformuar në pajtim me LAP-in. Stacionet policore dhe NJRKRR-të ballafaqohen me vështirësi që sfidojnë ndërmarrjen e hapave në kryerjen e aktiviteteve për të siguruar ambient të sigurt në trafikun rrugor. Ofrimin e sigurisë në trafikun rrugor e sfidojnë edhe faktorë tjerë, si: numri i madh i punonjësve policorë të shtyrë në moshë, mungesat për shkak të trajnimeve dhe pushimeve, duke e bërë të vështirë gjendjen me personel në ekipe patrulluese gjatë ndërrimeve. Shqetësues mbetet fakti i ndërrimit të tretë, ku bazuar në oraret e ndërrimit ka vështirësi për mbulim dhe funksionalizim të ndërrimit me personel. Menaxherët në ndërrime të caktuara kanë qenë të hendikepuar për funksionim normal të ekipeve policore për të ushtruar aktivitete dhe për t'iu përgjigjur nevojave policore brenda zonave të tyre të përgjegjësisë. Mbulimi i zonave të përgjegjësisë së stacioneve dhe NJRKRR-ve realizohet nga ekipet patrulluese në tri ndërrime nga tetë (8) orë, duke realizuar aktivitete 24 orësh. Orari i punës për ekipet patrulluese në kuadër të zonave të përgjegjësisë mbulohet 24 orë nga njësitë reaguese të stacioneve. Orari i punës për ekipet patrulluese të sektorëve në stacione mbulohet nga dy ndërrimet e para (07-15h dhe 15-23h), kurse personeli i sektorëve gjatë ndërrimit të tretë (23-07h) në disa stacione që kanë mungesa të personelit angazhohet në mbështetje të ekipeve reaguese në kuadër të ndërrimeve kujdestare.

#### **Rekomandimi nr. 1**

*IPK-ja u rekomandon Departamentit të Operacioneve, Divizionit për Siguri Publike dhe Drejtorive Rajonale Policore që të shqyrtojnë nevojat e njësive të trafikut dhe stacioneve dhe të plotësojnë strukturën e personelit në përputhje me Listën e Autorizuar të Personelit, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për punë efikase në ofrimin e sigurisë në rrugë.*

3.1.4. Aktiviteti patrullues nga njësitë patrulluese aplikohet me patrullime në lëvizje brenda zonave të përgjegjësisë, si dhe patrullime duke ngritur pika statike të kontrollit policor në të ashtuquajturat 'pika të zeza', me qëllim të ofrimit të sigurisë në rrugë. Varësisht prej nevojave operacionale, njësitë policore brenda zonave të tyre të përgjegjësisë aplikojnë metodologji të patrullimit me automjete, patrullimit në këmbë si dhe varësisht nga sezona, aplikohet edhe patrullimi me biçikleta. Oraret ditore të detyrave patrulluese në stacione dhe NJRKRR hartohen nga udhëheqësit e ndërrimeve të tyre mbi bazën e vlerësimeve të situatave, vendeve me frekuentim më të madh dhe mbi bazën e ngjarjeve që ndodhin apo mund të ndodhin brenda orarëve të caktuara të patrullimit. Kordinatorët e sektorëve në stacione hartojnë plane dhe orare patrulluese të njësive, që inkorporohen brenda orarit të ndërrimit nga udhëheqësi i ndërrimit.

3.1.5. Në stacione policore, NJRKRR dhe NJKA, gjatë 24 orëve, në kuadër të secilit ndërrim operojnë bazat e radio-komunikimit, të cilat janë përgjigjëse për komunikim dhe koordinim të stafit menaxhues të stacioneve dhe njësive me ekipet policore në terren gjatë aktivitetit policor patrullues dhe reagimit të njësive, në përgjigje të rasteve për intervenim. Ekipet patrulluese në terren gjatë gjithë orarit të punës janë të detyruara të raportojnë përmes sistemit të radio-komunikimit me bazën e stacionit apo njësisë policore lidhur me rrjedhën e aktivitetit patrullues, përfshirë lëvizjet e patrullimit, gjendjen që perceptohet nga terreni dhe zhvillimet apo ngjarjet që patrullat policore hasin gjatë aktivitetit patrullues. Në stacione dhe NJRKRR janë marrë dhe inspektuar mostrat e logjeve të ngjarjeve ditore për periudhën kur është zhvilluar inspektimi. Të

gjitha njësitë dhe stacionet policore të inspektura mbajnë shënime në log nga zyrtarët kujdestar për radio-komunikim. Në shumicën e stacioneve policore, me përjashtim të disa stacioneve të DRP-së së Prishtinës, nuk shënohen të dhënat e plota lidhur me kohën e reagimit të ekipeve policore, kohën e arritjes së ekipit policor në vendngjarje dhe kohën e realizimit apo përfundimit të rastit në terren. Nga mungesa e këtyre shënimeve në log, është e pamundur të përcaktohet apo nxjerret koha apo shpejtësia e reagimit policor në përgjigje të rasteve për intervenim. Si pasojë e kësaj dukurie, IPK-ja vlerëson se mungesa e shënimeve të plota nuk jep një pasqyrë të saktë lidhur me efektivitetin e reagimit policor. Lidhur me llogaridhënien, ekipet patrulluese të stacioneve policor dhe njësi të trafikut në terren, gjatë gjithë orarit të punës janë të detyruara të raportojnë më shkrim përmes formave standarde të raportimit (fletëpatrullat) mbi aktivitetin patrullues, ku secili ekip është i obliguar të pasqyrojë të dhënat lidhur me angazhimin e plotë ditor. Për gjithë aktivitetet e ndërrimit të stacioneve policore apo njësi të trafikut, shefat e ndërrimeve hartojnë raporte përmbledhëse, duke iu bashkëngjitur edhe raportet e ekipeve patrulluese të ndërrimit dhe kopje të radiologjeve, në mënyrë që t'i dorëzohen ndërrimit pasues për të pasur pasqyrë mbi situatën dhe detyrat e dhëna. Inspektimi i raporteve të ndërrimit dhe fletëpatrullave në stacione policore dhe njësi të trafikut vë në pah se në shumicën e stacioneve (në përjashtim të disa stacioneve), zyrtarët policorë të ekipeve patrulluese nuk bëjnë përshkrim detal të aktivitetit ditor mbi ngjarjet dhe aktivitetet, duke shënuar vetëm sipërfaqësisht aktivitetet e tyre patrulluese.

#### **Rekomandimi nr. 2**

*IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore dhe të NJRKRR-ve që të inkurajojnë personelin policor të ndërrimeve, që shënimet në logun e ngjarjeve ditore të jenë më të plota duke përfshirë kohën e përgjigjes së ekipeve policore në rast, kohën e arritjes së ekipit policor në vend-ngjarje dhe kohën e realizimit (përfundimit) të aktivitetit në terren.*

3.1.6. Në DKRR, së paku një herë në muaj dhe sipas nevojës mbahen takime të përbashkëta me menaxherët e NJRKRR-ve, në të cilat shqyrtohen rezultatet e punës, qasja strategjike në punë dhe aktivitetet për ruajtjen e sigurisë në komunikacionin rrugor. Takimet e tilla ndihmojnë Divizionin për hartimin e politikave, masave preventive dhe adresimin e problemeve lidhur me sigurinë në komunikacion. Sistemi i ushtrimit të kontrollit ndaj njësi patrulluese në stacione policore dhe njësi aplikohet përmes procesit të inspektiveve në terren nga ana e menaxherëve. Nga raportet e siguruar është vërtetuar se gjatë vitit 2016, shumica e stacioneve policore dhe NJRKRR-ve janë inspektuar nga menaxhmenti i tyre në baza mujore për të vlerësuar respektimin dhe mbarëvajtjen e punës nga ekipet patrulluese. Ky sistem i kontrollit aplikohet ndaj njësi dhe ekipeve patrulluese si në objektet e stacioneve dhe njësi përkatëse, ashtu edhe në terren gjatë aktiviteteve patrulluese. Nga raportet e inspektiveve është vërejtur se fokus i tyre zakonisht është gjendja e automjeteve dhe përdorimi i tyre, pajimi i tyre me pajisjet e nevojshme policore, etj. Organizimi i kontrolleve nga menaxhmenti mund të ndikojë dukshëm në vigjilencën e personelit për përkushtim të duhur në kryerjen e detyrave. Duhet patur parasysh se ushtrimi i kontrollit të kryerjes së detyrave reflekton edhe në ngritjen e motivit për punë.



3.1.7. Për shkak të dyshimeve për përfshirje në vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autoritetit zyrtar, marrjes së mitos dhe shkeljeve tjera, është suspenduar numër i konsideruar i zyrtarëve policorë nga NJRKRR e Mitrovicës së Jugut, Mitrovicës së Veriut, Prizrenit dhe NJKA-së. E gjithë kjo kishte dëmtuar imazhin policor, duke krijuar perceptim jo të mirë, duke shkaktuar vështirësi për funksionim normal të këtyre njësive. Për rrjedhojë, në NJRKRR-në e Mitrovicës së Jugut, Mitrovicës së Veriut, Prizrenit dhe NJKA janë shfaqur probleme në menaxhimin e orareve ditore të punës, për shkak të reduktimit të kapaciteteve. Menaxherët e hendikepuar nga kufizimet e burimeve njerëzore si pasojë e suspendimit të zyrtarëve policorë, kanë menaxhuar në kushte jo të favorshme, duke angazhuar të gjithë oficerët policorë në ekipe patrulluese, në detyra patrulluese (përfshirë dhe stafin policor menaxhues të njësive dhe stafin e sektorëve të hetimeve). Pozitat udhëheqëse të NJRKRR-ve të Mitrovicës së Jugut, Mitrovicës së Veriut dhe NJKA-së, më pas janë zëvendësuar me personel të ri menaxherial. Është vlerësuar se zyrtarët policor të suspenduar kishin punuar së bashku për një periudhë të konsiderueshme në orare dhe ekipe patrulluese të njejta. Pas këtyre zhvillimeve, kanë filluar të aplikohen ndryshime rrotative të orareve dhe ekipeve në baza mujore me qëllim të parandalimit të krijimit të marrëdhënieve përtej atyre zyrtare në radhët e zyrtarëve policorë në kuadër të këtyre njësive. Menaxhmenti i njësive dhe stacioneve policore, me rastin e menaxhimit dhe shpërndarjes së personelit policor në ndërrime dhe ekipe patrulluese, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, parandalimit dhe eliminimit të dukurive negative në radhët e njësive patrulluese, duhet në vazhdimësi të jenë të vëmendshëm që të aplikojnë masat e mbikëqyrjes duke aplikuar ndryshimet e nevojshme të personelit në orare nga ndërrimi në ndërrim dhe ekipi në ekip, ndaj të gjithë zyrtarëve policorë operativ.

### ***Rekomandimi nr. 3***

*IPK-ja u rekomandon menaxhmenteve të stacioneve policore, NJRKRR-ve dhe NJKA-së që të realizojnë praktika të vazhdueshme të rrotacionit për personelin policor në kuadër të orareve dhe ekipeve patrulluese, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, parandalimit dhe eliminimit të dukurive negative në radhët e njësive, përkatësisht ekipeve patrulluese policore.*

3.1.8. Patrullat policore në të shumtën e rasteve në aktivitetet policore janë të parat që arrijnë në vendngjarje, si në rastet e aksidenteve të komunikacioni, vjedhje, vrasje, dhunë e raste të tjera dhe aktiviteti i tyre në këto raste mund të ndikojë në masë të madhe në rezultatet e mëvonshme në aktivitetet policore. Është vërtetuar se personeli policor i angazhuar në NJRKRR dhe NJKA është në masë të konsiderueshme i trajnuar me trajnime nga fusha e menaxhimit me aksidente, ndërsa personeli policor i stacioneve policore nga njësitë reaguese dhe ekipet sektoriale kanë nevojë të përfshihen me shumë në trajnimet e menaxhimit të aksidenteve të trafikut. Në stacione policore, në kuadër të ekipeve dhe ndërrimeve ka një numër të konsiderueshëm të zyrtarëve policorë që nuk janë të trajnuar mjaftueshëm për trajtimin dhe menaxhimin e aksidenteve në trafik. Ekipet policore në kuadër të ndërrimeve dhe sektorëve, gjatë punës mund të janë të hendikepuar me mungesë të personelit të trajnuar për trajtimin e aksidenteve të trafikut, andaj stacionet policore inkurajohen që të analizojnë nevojat për përfshirje të zyrtarëve policorë në programe të avansuara trajnuese në fushën përkatëse.

## 3.2. Strategjia dhe planet për sigurinë rrugore

3.2.1. Me synim të arritjes së nivelit të kënaqshëm të sigurisë së përgjithshme rrugore, me trende të rënies së numrit të fataliteteve dhe të të lënduarve nga aksidentet e komunikacionit, Qeveria e Kosovës, konkretisht Ministria e Infrastrukturës në partneritet me mekanizmat relevant vendorë dhe të Bashkimit Evropian, në korrik të vitit 2015 ka hartuar Strategjinë e Sigurisë Rrugore 2016-2020 dhe Planin e Veprimit në Kosovë<sup>2</sup>, në të cilën ka përcaktuar objektivat kyçe për akterët relevant si implementues të këtij dokumenti, ku rol kyç ka edhe Policia e Kosovës. Kjo Strategji synon ndërmarrjen e masave konkrete në zvogëlimin e fataliteteve nga aksidentet rrugore në masën prej 50%, lëndimeve serioze në masën prej 30% dhe aksidenteve për 10%, duke krahasuar vitin 2019 me vitin 2007. Plani i Veprimit përbëhet nga 12 fusha prioritare, të cilat përmbajnë 130 masa konkrete që parashihen të ndërmerren në ngritjen e sigurisë rrugore.

3.2.2. PK-ja në kuadër të aktivitetit planifikues strategjik ka hartuar Planin Zhvillimor Strategjik (2016-2020), një nga objektivat e të cilit mbështetet në ato të Strategjisë kombëtare për Siguri Rrugore. Në mesin e objektivave është edhe objektivi që përfshin ‘ofrimin e sigurisë publike dhe forcimin e bashkëpunimit me qytetarë’<sup>3</sup>. Objektivi përfshin një sërë objektivash specifike, ku veç tjerash, edhe atë mbi ‘ngritjen e nivelit të sigurisë në komunikacionin rrugor dhe parandalimin e aksidenteve’. Për realizimin e objektivave që dalin nga Plani Zhvillimor Strategjik, Departamenti për Operacione i PK-së për vitin 2016 ka nxjerrë Planin Vjetor të Punës (2016), në të cilin ka zënë vend të çmuar fusha e ngritjes së nivelit të sigurisë në komunikacionin rrugor dhe parandalimit të aksidenteve. IPK-ja çmon përkushtimin e menaxhemntit të lartë të PK-së, duke i dhënë vend të veçantë çështjeve që lidhen me krijimin e kushteve më të mira në trafik.

3.2.3. Strategjia e Sigurisë Rrugore, Plani i Veprimit dhe Plani Vjetor i PK-së ka përcaktuar aktivitete të natyrës së fushatave vetëdijesuese mbi komunikacionin rrugor dhe sigurinë në rrugë. Bazuar në Raportin e DKRR-së<sup>4</sup>, është realizuar numër i konsideruar i ligjëratave në institucione arsimore, aktivitete mediale me rastin e shënimit të ngjarjeve të rëndësishme (Dita Botërore e përkujtimit të viktimave të trafikut rrugor dhe Dita e dhurimit vullnetar të gjakut), lansimi i spoteve televizive me përmbajtje vetëdijesuese, marshi në nderim të viktimave të trafikut, shpërndarja e broshurave me mesazhe për ngritjen e sigurisë në trafik, prezantimi në medime televizive mbi gjendjen e sigurisë dhe aktivitete tjera. Këto aktivitete vlerësohen pozitivisht dhe inkurajohet edhe më tutje DKRR-ja dhe akterët tjerë të përfshirë në proces, si Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP), forumet e sigurisë e partnerë të tjerë, që të vazhdojnë me këto angazhime senzibilizuese drejt sigurimit të një ambienti të sigurt në rrugë.

3.2.4. Në ndërmarrjen e masave konkrete të përcaktuara, rol me rëndësi zë edhe pajimi i PK-së me pajisje teknike që krijojnë cilësi të shërbimit në ngritjen e sigurisë në trafik. IPK-ja është interesuar të sigurojë informacion mbi angazhimet policore në përmirësimin e pajisjeve teknike të zbatimit të masave ligjore (pajisje për rregullim, kontrollim, identifikim dhe dëshmim të kundërvajtjeve). Edhe pse ky aktivitet është planifikuar të kryhet gjatë vitit 2016, sipas DKRR-së, ende nuk është realizuar projekti në fjalë. Është vlerësuar se kjo ngecie ka ardhur si rezultat i

<sup>2</sup> Ministria e Infrastrukturës, *Strategjia e Sigurisë Rrugore dhe Plani i Veprimit në Kosovë*, korrik 2015, Prishtinë.

<sup>3</sup> Policia e Kosovës, *Plani Zhvillimor Strategjik i Policisë së Kosovës (2016-20120)*, Prishtinë.

<sup>4</sup> Divizioni i Komunikacionit Rrugor, *Raporti Vjetor 2016*.

mungesës së buxhetit, duke shtyrë realizimin e projektit në fjalë tek në vitin 2017. IPK-ja vlerëson se pajisjet teknike paraqesin mjete të punës dhe furnizimi me këto pajisje apo modernizimi i tyre paraqet një faktor me rëndësi drejt ngritjes së sigurisë në trafik dhe disiplinimin e pjesëmarrësve.

#### **Rekomandimi nr. 4**

*IPK-ja i rekomandon Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që të trajtojë me kujdes çështjen e pajimit të njërive të trafikut rrugor me pajisjet e nevojshme të punës (pajisje për rregullim, kontrollim, identifikim dhe dëshmim të kundërvajtjeve).*

3.2.5. Strategjia e Sigurisë Rrugore dhe Plani Veprues ka përcaktuar edhe rolet e të gjithë akterëve në identifikimin e pikave të rrezikshme nga inspektimet e sigurisë rrugore. Roli i Policisë si akter brenda Planit Strategjik, konsiderohet të jetë kyç. Në drejtim të mbështetjes së proceseve drejt identifikimit të pikave të rrezikshme, PK-ja ka qenë aktive në vazhdimësi. Zyra për Infrastrukturë Rrugore ka hartuar 83 raporte me analiza dhe rekomandime për akterët, përfshirë Ministrinë e Infrastrukturës dhe komunat, duke potencuar pikat e zeza si vende me rrezikshmëri që rrezikojnë sigurinë e përgjithshme të pjesëmarrësve në trafik. PK-ja është përfshirë në një Grup punues, me iniciativë të Ministrisë së Infrastrukturës, me qëllim të identifikimit të vendeve të rrezikshme (pikave të zeza) dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tyre. Me gjithë gatishmërinë e PK-së për të kontribuar në identifikimin e vendeve me rrezikshmëri, nuk vërehet të kenë ecur gjërat përpara. IPK-ja vlerëson se duhet trajtuar me seriozitet kjo fushë dhe inkurajon PK-në që të kontribuojë në aktivitetet e mëtejme të Grupit të themeluar Punues, drejt identifikimit të pikave të zeza dhe dhënien e rekomandimeve për eliminimin e tyre.

3.2.6. Pjesë e masave të përbashkëta në ngritjen e sigurisë së përgjithshme rrugore është edhe asistimi policor në kontrollimin e mjeteve të transportit të udhëtarëve, mallrave dhe matjen e mbingarkesës boshtore. Raportet e DKRR-së flasin për një numër aktivitetesh të realizuara në këtë drejtim, ku duhet cekur mbështetjen policore dhënë Inspektoratit të Ministrisë së Infrastrukturës për kontrollimin e transportit të udhëtarëve dhe mallrave, por edhe asistimin e njërive të trafikut në aktivitetet e Drejtorisë së Menaxhimit të Rrugëve, në matjen e ngarkesave boshtore të mjeteve të rënda transportuese. Nuk duhet anashkaluar edhe angazhimet e këtyre njërive në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, në vlerësimin e sistemit të fizibilitetit të kontrollimit teknik të automjeteve. Të gjitha këto aktivitete të realizuara në disa drejtime, janë arritur përmes një numri planesh. Përfshirja e këtyre akterëve në realizimin e Strategjisë rrugore përmes këtyre aktiviteteve ka si rezultat ndërmarrjen e masave të kontrollit për ngritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor. Angazhimet e tilla kanë efekt pozitiv dhe inkurajohet Policia që të vazhdojë bashkëpunimin me akterët tjerë në realizimin e objektivave strategjike.

### **3.3. Performanca policore në ngritjen e sigurisë së përgjithshme në trafik**

3.3.1. Në përmbushjen e detyrave ligjore në sigurinë e qytetarëve, PK-ja organizon patrullime policore, të cilat kanë për detyrë monitorimin e një zone të caktuar gjeografike, duke lëvizur me automjete apo në këmbë, si dhe qëndrime statike në vende të caktuara. Patrullat policore bëjnë identifikimin e parregullësive në çështjen e sigurisë, mbledhjen e informatave lidhur me krimin, arrestime, zbatimin e ligjit në rregullimin e komunikacionit rrugor dhe masa tjera për parandalimin e krimit. Aktivitetet patrulluese, PK-ja i realizon përmes angazhimit të stacioneve policore në varësi të DRP-ve, mandej NJRKRR-ve e NJKA-së, që gjithashtu përmes aktiviteteve të tyre

patrulluese ofrojnë siguri brenda zonave të përgjegjesisë. Aktiviteti patrullues arrihet në përputhje me mbulimin e zonës së përgjegjesisë, të ndarë ndërmjet NJRKRR-ve dhe stacioneve policore. Derisa, përcaktimin e zonës së përgjegjesisë, stacionet policore e kanë të përcaktuar në bazë të km<sup>2</sup> të kufijve gjeografik, NJRKRR-të dhe NJKA-ja, zonën e përgjegjesisë e kanë të definuar me vijë-gjatësi të rrugëve magjistrale dhe autostradë që kontrollojnë. Bazuar në të dhënat mbi gjatësinë e rrugëve magjistrale dhe rajonale në kompetencë të NJRKRR-ve, si dhe autostradës që kontrollojnë NJKA-ja, rezulton se këto kontrollojnë rreth 2.032 km rrugë.


3.3.2. Për të vlerësuar trendet apo indikatorët e përgjithshëm të sigurisë në trafikun rrugor, IPK-ja ka analizuar dhe vlerësuar një numër të tyre në tri nivelet e organizimit: në nivel të stacioneve, NJRKRR-ve dhe NJKA-së. Pasqyrohen indikatorë kundërthënës kur marrim parasysh raportin në mes të angazhimit pro-aktiv policor dhe numrit të shtuar të aksidenteve për vitet e krahasuara. Në nivel vendi vlerësohet se numri i aksidenteve është ngritur viteve të fundit në vazhdimësi, kurse nëse i referohemi numrit të personave të vdekur në aksidente del se viti 2016 ka qenë vit me numrin më të ulët të të vdekurve në aksidente në dhjetë (10) vitet e fundit. Trendi me rënie të numrit të të vdekurve ka filluar që nga viti 2011 kur janë evidentuar 157 raste, për të rënë në 99 raste në vitin e fundit. Praktikant ndërkombëtare të llogaritjes së trendeve lidhur me sigurinë rrugore zakonisht marrin parasysh dy elemente kryesore: numrin e të vdekurve në 100.000 banorë dhe numrin e të vdekurve në 100.000 automjete. Bazuar në këta dy parametra, Kosova del të jetë e renditur në një pozitë më të lakmueshme se vendet e rajonit, por që nuk është e duhur për të arritur mesataren e Bashkimit Evropian. Në tre vitet e fundit, mesatarisht numri i të vdekurve në 100.000 banorë sillet nga 6 deri 7, derisa numri i të vdekurve në 100.000 automjete sillet nga 36 deri 43 të vdekur. Andaj, duke kuptuar se krijimi i një klime të sigurtë në trafik nuk varet vetëm nga angazhimi policor, IPK-ja inkurajon PK-në që në vazhdimësi të ndërmarrë veprime të nevojshme pro-aktive dhe reaktive që i kontribuojnë përmirësimit të kësaj gjendjeje, si një nga akterët kontribues për siguri në rrugë.

3.3.3. Kur flasim për sigurinë rrugore në vend, duhet kuptuar se në performancën qoftë pozitive apo negative ndikohet nga angazhimi apo mos angazhimi i disa akterëve që janë të përfshirë në përmbushjen e objektivave strategjike të sigurisë rrugore. Meqë jemi të orientuar të përcjellim performancën policore brenda këtyre angazhimeve të përbashkëta, duhet studjuar indikatorët që faktojnë angazhimet policore në ngritjen e sigurisë rrugore, që janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme. Duke iu referuar indikatorit ‘numri i aksidenteve’, është në ngritje trendi siç janë në ngritje edhe indikatorët e masave pro-aktive të sigurisë në rrugë. Ngritja e masave nga instanca policore nuk ka ndikuar në rënien e numrit të aksidenteve. Me gjithë shtimin e tyre, është ngritur edhe numri i aksidenteve në nivel vendi. Duke krahasuar vitet 2015/2016, aksidentet janë shtuar për 3%, krahas shtimit të gjobave për 6%, patrullimeve për 1% dhe pikave të kontrollit për 3%.

<b>Tabela 1. Të dhëna përmbledhëse krahasimore mbi aksidentet dhe masat pro-aktive të njësive policore në ngritjen e sigurisë së përgjithshme në komunikacion (2015/2016)</b>								
Indikatorët	Stacionet policore		NJKRR		NJKA		Gjithsej	
	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Aksidente	10.638	9.453	7.137	8.810	365	402	18.140	18.665
Gjobat	112.102	121.162	172.601	180.676	20.684	22.306	305.387	324.144
Patrullimet	59.459	60.481	24.379	24.321	2.532	2.848	86.370	87.650
Pika kontrolli	68.599	70.542	65.277	65.518	8.411	9.833	142.287	145.893



3.3.4. Nga analiza në nivel stacionesh policore, përgjithësisht numri i aksidenteve të ndodhura brenda zonave të tyre të përgjegjesisë ka pësuar rënie për 11% në krahasim me vitin 2015. NJRKRR-të kanë shënuar shtim të numrit të aksidenteve për 19%, kurse NJKA-ja ka shënuar një numër aksidentesh që është për 10% më i lartë se në vitin paraprak. Në nivel të stacioneve policore, masat e ndërmarra pro-aktive policore duket të jenë treguar më produktive dhe efikase, gjithmonë kur kemi parasysh shqiptimin e gjobave për shkaktimin e kundërvajtjeve në trafik, patrullimet me automjete dhe vendosjen e pikave të kontrollit. Në tri nivelet janë shtuar aktivitetet policore të cekura më lartë. Stacionet policore kanë ngritur numrin e gjobave për kundërvajtje në trafik për 8%, NJRKRR-të për 5% dhe NJKA-ja për 6%. Patrullimet me automjete në kuadër të zonës së përgjegjesisë së stacioneve policore janë shtuar për 2%, në NJRKRR janë të pandryshuara dhe te NJKA kjo shifër është ngritur për 1%. Patrullimet janë përcjellur edhe me vendosje të pikave të kontrollit, që në kuadër të stacioneve arrin shtimin për 3%, në NJRKRR nuk evidentohet ngritje, kurse në NJKA këto aktivitete shënojnë ngritje për 17%. IPK-ja vlerëson performancën policore në pasqyrimin e aktiviteteve patrulluese përmes raporteve periodike me analiza të thukta, të cilat ndihmojnë strukturën policore në identifikimin e trendeve mbi indikatorët e performancës.



3.3.5. Nëse krahasojmë të dhënat mbi masat pro-aktive policore të ngritjes së sigurisë në rrugë (numrin e patrullimeve, pikat e kontrollit dhe numrin e gjobave të shqiptuara për kundërvajtje në trafik), pasqyrojmë se gjatë vitit 2015, përgjithësisht stacionet gjatë një patrullimi në rrugët që i kanë nën kompetencë, kanë vendosur mesatarisht 1.2 pika të kontrollit dhe kanë shqiptuar 1.9 gjoba për kundërvajtje në trafik, kurse në vitin 2016, këto shifra sillen në 1.2 pika kontrolli dhe 2 gjoba të shqiptuara. NJRKRR-të gjatë një patrullimi të realizuar në vitin 2015, kanë vendosur mesatarisht 2.7 pika kontrolli dhe kanë shqiptuar 7.1 gjoba, kurse në vitin 2016, shifrat arrijnë në 2.7 pika kontrolli dhe mesatarisht 7.4 gjoba të shqiptuara. NJKA-ja gjatë një patrullimi të realizuar në vitin 2015, në autostradë ka vendosur mesatarisht 3.3 pika kontrolli dhe ka shqiptuar 8.2 gjoba, kurse në vitin 2016, shifrat arrijnë në 3.5 pika kontrolli dhe mesatarisht 7.8 gjoba të shqiptuara.

3.3.6. Dy (2) nga 11 stacione policore të kategorisë A (Ferizaj, Gjakovë), pesë (5) nga 20 stacione të kategorisë B (Prizren Veriu, Fushë Kosovë, Lipjan, Skënderaj, Shtërpçë) dhe dy (2) nga 10 stacione të kategorisë C (Graçanicë, Novobërdë) kanë shënuar ngritje të numrit të aksidenteve të shkaktuara brenda zonës së tyre të përgjegjesisë. Të gjitha NJRKRR-të dhe NJKA kanë shënuar

ngritje të numrit të aksidenteve. Dallohet NJRKRR e Prizrenit dhe Gjilanit me numër shumë të rritur të aksidenteve për 85%, përkatësisht 62%. Është vlerësuar se nëntë (9) stacione policore nga të tri këto kategori, NJRKRR-të dhe NJKA kanë shënuar ngritje të numrit të rasteve të aksidenteve të trafikut duke mos përmbushë objektivin për ulje të numrit të aksidenteve. IPK çmon angazhimin dhe përpjekjet e stacioneve policore që kanë treguar përkushtim dhe performancë të mirë në uljen e trendit të aksidenteve, njëherit i inkurajon që të vazhdojnë më tutje drejt uljes së vazhdueshme të trendit të aksidenteve, duke përmirësuar sigurinë rrugore brenda zonave të tyre të përgjegjësisë.

3.3.7. Gjashtë (6) nga 11 stacione policore të kategorisë A (Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë Jugu, Mitrovicë Veriu, Pejë), shtatë (7) nga 20 stacione policore të kategorisë B (Prizren Veriu, Dragash, Fushë Kosova, Istog, Klinë, Podujevë, Zveçan), pesë (5) nga 10 stacione të kategorisë C (Graçanicë, Junik, Kllokot, Obiliq, Ranillug) kanë treguar rritje të numrit të aktivitetit patrullues me automjete gjatë vitit 2016 në krahasim me vitin 2015. Nëse krahasohet niveli i aktiviteteve patrulluese të NJRKRR-ve dhe NJKA-së, del se gjashtë (6) nga nëntë (9) prej tyre (NJKRR-Prizren, NJRKRR- Mitrovicë Jugu, NJRKRR- Mitrovicë Veriu, NJRKRR- Gjilan, NJRKRR- Pejë, NJKA) kanë shënuar ngritje të aktivitetit patrullues në krahasim me vitin 2015. Dallohet NJRKRR e Gjakovës dhe NJKA me numër dukshëm të shtuar të aktivitetit patrullues për 14%, përkatësisht 12%. IPK-ja çmon angazhimin dhe përpjekjet e stacioneve policore dhe njërive të trafikut, të cilat kanë treguar përkushtim dhe performancë të mirë në aktivitete të patrullimit gjatë vitit 2016, duke i inkurajuar që në vazhdimësi të angazhohen në përmirësimin e gjendjes së sigurisë në trafik.

3.3.8. Gjatë patrullimit brenda zonave të përgjegjësisë së njërive të trafikut/ stacioneve policore, ekipet e patrullimit shpeshherë hasin në ngasës që duke mos iu përshtatur rregullave të trafikut, shkaktojnë kundërvajtje. Me qëllim të ngritjes së shkallës së sigurisë në komunikacion, të uljes së kundërvajtjeve të shaktuara në trafik dhe me qëllim të vetëdijësimit të ngasësve, zyrtarët policorë shqiptojnë gjoha ndëshkuese ndaj atyre që shkelin rregullat e përcaktuara me Ligjin për Siguri në Komunikacionin Rrugor. Duke analizuar performancën e PK-së në këtë fushë, shihet se shtatë (7) nga 11 stacione policore të kategorisë A (Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë Jugu, Mitrovicë Veriu, Pejë, Prishtinë Jugu, Prishtinë Veriu), 12 nga 20 stacione policore të kategorisë B (Prizren Veriu, Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Istog, Kamenicë, Klinë, Malishevë, Rahovec, Skënderaj, Viti, Zveçan), si dhe tre (3) nga 10 stacione policore të kategorisë C (Kllokot, Obiliq, Mamushë) kanë shënuar ngritje të numrit të gjobave të shqiptuara. Shtatë nga nëntë (9) njësitë e trafikut rrugor (NJKRR-Prizren, NJRKRR- Mitrovicë Jugu, NJRKRR- Mitrovicë Veriu, NJRKRR- Gjakovë, NJRKRR- Gjilan, NJRKRR- Pejë, NJKA) kanë shënuar ngritje të numrit të gjobave të shqiptuara gjatë vitit 2016 në krahasim me vitin 2015. IPK-ja çmon angazhimin dhe përpjekjet e stacioneve, të cilat kanë treguar përkushtim dhe performancë të mirë, në angazhimin e aktiviteteve pro-aktive dhe reaktive të patrullimit gjatë vitit 2016, njëherit i inkurajon ato që të vazhdojnë edhe më tutje drejt përpjekjeve për përmirësimin e gjendjes së sigurisë rrugore.

3.3.9. Në vitin 2016, NJRKRR-të dhe NJKA kanë realizuar 196 plane operative që është për 27% më pak se në vitin paraprak kur ishin realizuar 268 plane operative. Gjatë vitit 2016 krahasuar me periudhën e vitit 2015, tre (3) prej nëntë (9) NJRKRR-ve kanë shënuar ngritje të numrit të planeve operative. Numrin më të pakët të planeve operative e ka shënuar NJRKRR e Ferizajt me gjithsej pesë (5) sosh, kurse numrin më të madh e ka regjistruar ajo e Prishtinës, me gjithsej 41 plane. NJKA gjatë kësaj periudhe ka pasur 14 plane operative. IPK-ja çmon angazhimin dhe përpjekjet e

NJKRRR-ve që kanë treguar përkushtim dhe performancë të mirë në hartimin e planeve gjatë vitit 2016 dhe i inkurajon që në vazhdimësi të angazhohen në krijimin e një klime të sigurt në rrugë. IPK-ja nxitë menaxherët e njësive të trafikut, të cilat kanë pasur shkallë të ulët të angazhimeve dhe nxjerrjes së planeve operative, që në të ardhmen të bëjnë përpjekje maksimale në ngritjen e nivelit të organizimit dhe planifikimeve operative për t'iu përgjigjur situatave që kërkojnë angazhim.

#### **Rekomandimi nr. 5**

*IPK-ja rekomandon menaxherët e stacioneve policore dhe njësive të trafikut, të cilat kanë ngecur ose stagnuar në zbatimin e masave pro-aktive për siguri rrugore, që në të ardhmen të angazhohen maksimalisht në realizimin e instrumenteve të lejuar ligjor (shqiptimi i gjobave, patrullimi, pikat e kontrollit), drejt ngritjes së nivelit të sigurisë brenda zonave të përgjegjesisë së tyre.*

3.3.10. Duke studjuar lëvizjet e indikatorëve të performancës, janë disa situata apo raste që kërkojnë analizë më të thellë nga akterët përgjegjës. *Së pari*, marrim shembullin e NJRKRR-së së Gjakovës, e cila edhe pse ka ngritur numrin e patrullimeve, pikave të kontrollit dhe gjobave të trafikut, nuk ka arritur të ulë numrin e aksidenteve në krahasim me vitin paraprak, *Së dyti*, si pasojë e reduktimit të numrit të patrullimeve, pikave të kontrollit dhe gjobave, është shtuar numri i aksidenteve në kuadër të NJRKRR-së së Ferizajt. *Së treti*, marrim shembullin e NJRKRR-së së Gjilanit, e cila nuk ka shtuar në masë evidente masat pro-aktive e që ka pasuar me rritje të madhe të numrit të aksidenteve, *Së katërti*, rasti i NJRKRR-së së Prishtinës, ku aksidentet në trafik nuk janë shtuar, duke marrë parasysh ndërkohë shtimin e masave pro-aktive policore. Bazuar në të dhënat policore mbi gjendjen e sigurisë rrugore, vlerësohet se Divizioni i Komunikacionit Rrugor është duke bërë një punë të duhur dhe këto raporte mund t'i shërbejnë stacioneve policore dhe njësive të trafikut rrugor që të analizojnë efektet e masave të tyre pro-aktive të ndërmarra gjatë aktivitetit patrullues.

### **3.4. Pajisjet policore të njësive patrulluese**

3.4.1. Për kryerjen e aktiviteteve patrulluese policore, njësitë kompetente duhet të jenë të pajisura me pajisje të nevojshme për punë patrulluese. Stacionet policore të rendit rezultojnë se janë të pajisur me 73 pajisje për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve motorike në trafik, prej të cilëve, 44 sosh (60%) janë në gjendje të rregullt teknike. Janë 15 stacione policore që nuk posedojnë pajisje të tilla në gjendje të rregullt teknike. NJRKRR-të dhe NJKA janë të pajisur me gjithsej 72 pajisje për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve motorike në trafik, prej të cilëve, 49 sosh (68%) janë në gjendje të rregullt teknike. Është verifikuar se dy (2) nga nëntë (9) NJRKRR (Mitrovicë e Jugut dhe Mitrovicë e Veriut) nuk posedojnë fare pajisje funksionale për matjen e shpejtësisë së lëvizjes. Mungesa dhe jofunksionaliteti i pajisjeve për këto njësi shkakton pengesë të theksuar për performancë dhe rezultate pozitive në punë, meqë nuk kanë mundësi të shqiptojnë masa ndaj ngasësve që shkelin rregullat e komunikacionit. Nevojitet që menaxhmenti policor kompetent të angazhohet drejt përmirësimit të kushteve të punës, pajimit të stacioneve dhe njësive policore me pajisje të tilla dhe përmirësimin e gjendjes teknike të atyre ekzistuese.

3.4.2. Stacionet policore janë të pajisura me 129 pajisje për matjen e prezencës së alkoolit tek personat e dehur (alkooteste), prej të cilave, 53 sosh apo 41% janë në gjendje të rregullt teknike. Njësitë e trafikut rrugor janë të pajisur me 34 pajisje për matjen e prezencës së alkoolit tek personat e dehur, prej të cilave, 21 sosh (62%) janë në gjendje të rregullt teknike. NJRKRR e Mitrovicës së

Jugut dhe e Mitrovicës së Veriut nuk posedojnë fare alkooteste në gjendje të rregullt. Mungesa dhe mosfunktionaliteti i pajisjeve për këto njësi shkakton pengesë të theksuar për performancë dhe rezultate pozitive të punës, ngase ato nuk kanë mundësi të shqiptojnë masa ndaj ngasësve, të cilët shkelin rregullat e komunikacionit. Nevojitet që menaxhmenti policor kompetent të angazhohet drejt përmirësimit të kushteve, pajimit të ekipeve patrulluese me pajisje të tilla dhe përmirësimin e gjendjes së tyre teknike.

3.4.3. Prej 29 patrullave policore të inspektuara, shtatë (7) ekipe patrulluese kanë qenë të pajisura me pajisje për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve motorike, 27 ekipe patrulluese kanë qenë të pajisura me bllokun e kundërvajtjeve, 15 ekipe patrulluese kanë qenë të pajisura me dokumentet e fletë patrullës në terren, 16 ekipe patrulluese kanë qenë të pajisura me jelekë reflektues, gjashtë (6) ekipe patrulluese kanë qenë të pajisura me stopa dore.

***Rekomandimi nr. 6***

*IPK-ja i rekomandon Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që të marr masat e nevojshme për furnizimin me pajisjet e radarëve, alkotestëve dhe jelekëve reflektues për njësitë policore që ushtrojnë aktivitete patrulluese në sigurinë e trafikut rrugor.*



## 4. Plani i përbushjes së rekomandimeve

### 4.1.1. Plani për përbushjen e rekomandimeve

4.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 24 .10.2017, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Prioriteti	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja u rekomandon Departamentit të Operacioneve, Divizionit për Siguri Publike dhe Drejtorive Rajonale Policore që të shqyrtojnë nevojat e njësisë të trafikut dhe stacioneve dhe të plotësojnë strukturën e personelit në përputhje me Listën e Autorizuar të Personelit, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për punë efikase në ofrimin e sigurisë në rrugë.</i>	<i>II</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
2.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore dhe të NJRKRR-ve që të inkurajojnë personelin policor të ndërrimeve, që shënimet në logun e ngjarjeve ditore të jenë të plota duke përfshirë kohën e përgjigjes së ekipeve policore në rast, kohën e arritjes së ekipit policor në vend-ngjarje dhe kohën e realizimit (përfundimit) të aktivitetit në terren.</i>	<i>II</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm, është paraparë me Strategjinë e Policimit në Bashkësi dhe Planin e Veprimit 2017-2021 si objektivi specifik ku do të fillon me implementim nga viti 2018 “koha e reagimit”. Gjatë këtij viti do të hartohet PSO lidhur me këtë qasje dhe në të ardhmen do të jetë mundësia e matjes së kohës së reagimit për të gjitha rastet.</i>	<i>Viti 2018</i>
3.	<i>IPK-ja u rekomandon menaxhmenteve të stacioneve policore, NJRKRR-ve dhe NJKA-së që të realizojnë praktika të vazhdueshme të rrotacionit për personelin policor në kuadër të orarëve dhe ekipeve patrulluese, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, parandalimit dhe eliminimit të dukurive negative në radhët e njësisë, përkatësisht ekipeve policore.</i>	<i>I</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe i kontribuon ngritjes së performances së punës.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
4.	<i>IPK-ja i rekomandon Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që të trajtojë me kujdes çështjen e pajimit të njësisë të trafikut</i>	<i>I</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm, kurse procesi i plotësimit me</i>	<i>Në vazhdimësi</i>

	<i>rrugor me pajisjet e nevojshme të punës (pajisje për rregullim, kontrollim, identifikim dhe dëshim të kundërvajtjeve).</i>		<i>pajisje policore është në vazhdimësi</i>	
5.	<i>IPK-ja rekomandon menaxherët e stacioneve policore dhe njërive të trafikut, të cilat kanë ngecur ose stagnuar në zbatimin e masave pro-aktive, që në të ardhmen të angazhohen maksimalisht në realizimin e instrumenteve të lejuar ligjor drejt ngritjes së nivelit të sigurisë brenda zonave të përgjegjësisë së tyre.</i>	<i>I</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
6.	<i>IPK-ja i rekomandon Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që të marr masat e nevojshme për furnizimin me pajisjet e radarëve, alkoesteve dhe jelekëve reflektues për njësitë policore që ushtrojnë aktivitete patrulluese në sigurinë e trafikut rrugor.</i>	<i>I</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>

## Shtojcat

<b>Shtojca 1. Të dhëna mbi nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar</b>				
Nr.	Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2015)			Niveli i zbatimit po/jo
	Inspektimi: Menaxhimi i patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë, nr. 04/2015			
	Rekomandimi i dhënë	Komentet e strukturës policore	Afatet për zbatim	
1.	IPK-ja u rekomandon Divizionit për Siguri Publike, Drejtorive Rajonale të PK-së dhe Stacioneve policore të angazhohen maksimalisht në funksionalizimin e strukturës organizative dhe plotësimin e pozitive me personel policor të uniformuar.	Rekomandimi është i bazuar, real dhe i arritshëm. Për realizimin e tij, Divizioni për Siguri Publike gjithnjë i propozon menaxhmentit të lartë, ndryshimet strukturore bazuar në dinamikën e zhvillimit të PK-së dhe detyrave dhe aktiviteteve policore. Propozimet tona në të kaluarën kanë qenë që kategorizimi i stacioneve policore të zërthehet në gjashtë kategori dhe jo në tri, të shuhen nënstationet dhe në vend të tyre të kategorizohen në nivelin e sektorit policor, po ashtu janë bërë propozimet që të fuqizohen qendrat e komunikimit aty ku ka mundësi dhe ku ato mund të jenë operacionale (shembull: për tri st. pol. Veriu, Qendra dhe Jugu, qendra e komunikimit e DRP-Prishtinë dhe Trafikut Rajonal të udhëhiqen nga një qendër komunikimi), qendrat e mbajtjes të funksionojnë në nivel regjional nga një qendër. Nga këto ristrukturime përfitojmë në personel për nevoja operacionale. Gjithashtu, ka iniciativa që numri i policëve në sigurimin e objekteve të zvogëlohet, dhe në këtë mënyrë Policia e Kosovës, këta zyrtarë t'i angazhojë në plotësimin e strukturës organizative aty ku është e nevojshme. Vlen të ceket që ne si staf menaxhues gjithnjë jemi aktiv me propozimet tona për një strukturë më efektive dhe efektive.	Aktivitet në progres dhe jo i limituar në kohë. Ndryshimet strukturore janë dinamike dhe të përhershme.	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> Në proces
2.	IPK-ja i rekomandon Divizionit për Siguri Publike që të rishqyrtoj procedurat dhe kriteret e kategorizimit të disa	Në komentet të cilat i dhashë në rekomandimin e parë janë dhënë sqarimet në lidhje me iniciativat. Struktura e tanishme është bazuar nga një hulumtim njëvjeçar në vitin	Ne do t'i ri-përsërisim iniciativat dhe propozimet tona për	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> Në proces

	nga stacionet policore, të cilat për shkak të specifikave dhe kushteve të hapësirave gjeografike, numrit të madh të popullsisë brenda zonave të përgjegjësive kategorizimi i tyre nuk i përgjigjet nevojave dhe kërkesave karshi kapaciteteve momentale të burimeve policore.	2011 i formuar dhe i udhëhequr nga ekspert ndërkombëtar, të cilët i kanë propozuar PK-së bazuar në parametrat që ju i keni trajtuar gjatë inspektimit. Kapacitetet e burimeve njerëzore të PK-së në disa raste përcaktohen nga vendimet politike pa ndonjë nevojë operaconale. Këtu vlen të ceket: formimi i Njësisë së Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare me mbi 200 polic, pastaj integrimi i policëve të MUP-it të Serbisë në Policinë e Kosovës gjithsejt 287 pjesëtarë të cilët sipas marrëveshjes mund të caktohen në detyrë vetëm në DRP të Mitrovicës së Veriut, etj. Kjo ka ndikuar në shpërndarjen jo racionale të personelit, si dhe angazhimi i policëve jashtë detyrave primare policore, etj.	ndryshime. Realizimi i rekomandimit nuk përcaktohet	
3.	IPK u rekomandon Divizionit për Siguri Publike si dhe Divizionit të Komunikacionit Rrugor që të angazhohen në hartimin e një Procedure standarde të Operimit e cila do të definonte saktë kompetencën e menaxhimit me rastet e aksidenteve të trafikut ndërmjet NJRKRR-ve dhe stacioneve policore ngase ndarje e tillë e cila aplikohet në praktikë është mjaft e paqartë për të definuar në momentet kur ndodhin aksidentet se cilat aksidente konsiderohen me lëndime/dëme të lehta e cilat me lëndime/dëme të mëdha materiale.	Është rekomandim shumë i qëlluar. Ne do të marrim iniciativat që të formulohet Procedura Standarde e Operimit dhe të përcaktohen parametrat dhe kriteret në lidhje me menaxhimin e aksidenteve në trafik. PSO të autorizohet nga Drejtori i Departamentit të Operacioneve. Për momentin menaxhimi i aksidenteve bazohet në Udhëzuesin e trafikut (2012) si dhe Parimet dhe Procedurat e Policisë (P-5.18).	Afati i realizimit të rekomandimit 01.10.2015	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> Realizuar
4.	IPK-ja u rekomandon Divizionit për Siguri Publike, DRP-ve dhe të	Pajtohem plotësisht me rekomandimin. Pengesa në realizimin e këtij rekomandimi është	Afati viti 2016 gjashtëmujori i dytë.	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> Pjesërisht



	<p>gjitha stacioneve policore që të angazhohen më shumë me qëllim të ngritjes dhe funksionalizimit të njësitit të biçikletave i cili do të ushtronte aktivitet patrullues gjatë sezonës së verës.</p>	<p>pajisja dhe servisimi i biçikletave, si dhe trajnimi i personelit. Rreth pajisjes me biçikleta ka dështuar tenderi për blerjen e tyre, ndërsa në lidhje me trajnimin e policëve deri tani nuk ka pasur interes në mënyrën e duhur që në këtë trajnim të aplikojnë policët, por tani gjeneratat e policëve të rinj kanë shprehur dëshirë që në masë të madhe të trajnohen në drejtimin e biçikletave dhe të jenë pjesë e këtyre ekipeve, pas realizimit të trajnimit të tyre fushor, i cili zgjatë dy vjet nga trajnimi themelor në Vushtrri. Ne kemi ndërmarrë iniciativa që të formohen edhe njësi të motoçikletave për patrullim, tani gjendemi në fazën e tenderimit për këto pajisje.</p>		
5.	<p>IPK-ja u rekomandon të gjitha stacioneve policore përkundër vështirësive që kanë me pajisjen me vetura të inkurajon maksimalisht zbatimin e aktivitetit patrullues nëpër njësitë sektoriale me patrulla në këmbë.</p>	<p>Plotësisht pajtohem me rekomandimin e juaj. Misioni EULEX-it i ka dhuruar 37 automjete PK-së, 27 nga këto automjete do të ju shpërndahen stacioneve policore dhe DRP-ve. Tani jemi në fazën finale të vlerësimit të tenderit për automjete policore, me dinamikë të liferimit vjetor nga operatorët për 50 automjete për katër vitet e ardhme. Më lart e ceka që në të njëjtën kohë jemi në proces edhe për motoçikleta dhe biçikleta. Në këto katër vitet e fundit, PK-ja nuk është furnizuar me automjete policore, arsyeja dështimi i tenderimit. Ne si Divizion i Sigurisë Publike që tri vite me radhë i kemi parashtruar kërkesat tona për 140 automjete policore, 100 motoçikleta deri në 150 cc dhe 150 biçikleta dhe pajisje tjera policore, të cilat nuk specifikohen në këtë rekomandim.</p>	<p>Ne do t'i ripërsërisim iniciativat dhe propozimet tona për ndryshime. Realizimi i rekomandimit nuk përcaktohet.</p>	<p><b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> Plotësisht</p>
6.	<p>IPK-ja u rekomandon Divizionit për Siguri Publike dhe Divizionit të Komunikacionit Rrugor që të angazhohen për shpërndarje unike dhe</p>	<p>Të gjitha pajisjet për Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor dhe Njësinë për Kontrollin e Autostradave, sa i përket furnizimit dhe shpërndarjes realizohen nga Divizioni i Komunikacionit Rrugor, pas vlerësimit të nevojave për pajisje</p>	<p>Realizimi është në vazhdimësi.</p>	<p><b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> Pjesërisht</p>

<i>proporcionale të pajisjeve të njësive operative dhe mjeteve tjera të nevojshme operacionale për patrullim.</i>	<i>për të gjitha njësitë, përveç donacioneve të cilat me kërkesë të donatorit shpërndarja bëhet bazuar në kërkesën e donatorit.</i>		
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--